



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Planimat / Detezuar Pranimet/Pradato Received/Delivered	28-06-2021	1	viti god year
Organ /Agjencia Organ /Institution Org /Inst	DI-Prot Br-Prot Prof.No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3325/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.413/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.413/2021 të datës 12.05.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë Banimi Rr. "Vehbi Ibrahim" Nr.18, Lagjja Zabel, Komuna e Gjilanit, kundër Vendimit me numër reference KE-296/2021 të datës 27.04.2021 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 25.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.413/2021 e datës 12.05.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimin me numër reference KE-296/2021 i datës 27.04.2021 i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi ne datë 12.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2347/2021 e regjistruar me numër A.nr.413/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër reference KE-296/2021 i datës 27.04.2021 i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës me pretendimin ankimor se duhet t'i pranohet kontributi i meritës dhe autorësisë së zyrës shtesë në DKR pranë Agjencisë Pyjore të Kosovës në Gjilan në pajtim me Ligjin Nr.04/L-065 për Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 12.05.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 3247/2021; Kërkesën për qasje në dokumente publike e datës 06.05.2021; E-mailin e datës 06.05.2021 dërguar nga ankuesi për arkivën e Agjencisë Pyjore të



Kosovës; Kërkesën e datës 01.10.2018 dërguar nga ankuesi për menaxheren e Personelit të Agjencisë Pyjore të Kosovës; E-mailin e datës 01.10.2018 dërguar nga ankuesi për Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës; Kërkesën e datës 24.03.2011; Kërkesën për shqyrtim me prioritet të lëndës e datës 22.01.2020; Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.188/2021 të datës 14.04.2021; E-mailin e datës 06.10.2019 me korrespondencë e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; Njoftimin e datës 01.11.2019; E-mailin e datës 22.06.2019 dërguar nga ankuesi për me korrespondencën e bashkangjitur prej katër (4) faqesh; Shkresën për plotësimin e lëndës e datës 28.04.2021; E-mailin e datës 28.04.2021 dërguar nga ankuesi për Arkivën e Agjencisë Pyjore të Kosovës; E-mailin e ankuesit të datës 12.05.2021 dërguar nga ankuesi për KPMSHCK; Njoftimin e Agjencisë Pyjore të Kosovës të datës 27.04.2021 të pranuar në Këshill me datë 29.04.2021 dhe numër protokoll:2056/2021; Vendimin Ref:KE-296/2021 i datës 27.04.2021 i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës; Ankesën e datës 09.10.2019 me numër protokoll 4716/2019 të parashtruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimin e datës 31.02.2012 me numër ZP-83/2021; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 01.12.2008 me numër:01/2008; Formularin e Regjistrimit të ankesës së ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Kërkesën e datës 10.05.2019 me numër SBNJH-206/19 për ri-shqyrtimin e vlerësimit të rezultateve në punë të vitit 2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 të datës 24.12.2018; E-mailin e datës 29.12.2018 dërguar nga ankuesi për ne e-maillet e bashkangjitura të datës 01.10.2018; Kërkesën e datës 28.12.2018 për rishqyrtimin e rezultateve në punë të vitit 2018; Emailin e datës 29.12.2018 dërguar nga ankuesi për me e-maillet e bashkangjitura; Njoftimin e datës 13.12.2018; Shkresën e titulluar Lënda: Akt Përcjellës; E-mailin e datës 13.12.2018 dërguar nga ankuesi për Kërkesën e datës 26.11.2018 me numër REF.GJIO/APK: 208/2018; E-mailin e datës 26.11.2018 dërguar nga ankuesi për Shkresën e titulluar Lënda: Akt Përcjellës; faqe 02 nga 02; Kërkesën e datës 24.07.2019 me numër:10 për pranimin e kontributit si meritë në autorësinë e zyrës shtesë në drejtori; Kërkesën e datës 25.01.2019 me numër SBNJH-53/2019 më përmbajtje në 5 (tre) faqe; Kërkesën e datës 29.05.2019 me numër Ref:322/19 dërguar për Kërkesën e datës 29.05.2019 me numër Ref:322/19 dërguar për Ankesën e plotësuar e datës 10.10.2019 me numër protokoll:4733/2019 me e-maillet e datës 08.10.2019 dhe 09.10.2019 me 5 (pesë) faqe të bashkangjitura; Njoftimin e datës 26.11.2018 me shkresat e bashkangjitura prej 3 (tre) faqesh; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.10.2019; Përgjigjen në ankesë të datës 21.10.2019; Përshkrimin e detyrave të a punës për ankuesin; E-mailin e datës 17.10.2019 dërguar nga për Emailin e datës 17.10.2019 dërguar nga për Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative numër A.nr. 3068/19 të datës 12.03.2021; Emailin e ankuesit të datës 29.03.2021 dërguar në adresën elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net me numër protokoll:1463/2021 me shkresat e bashkangjitura prej dhjetë (10) faqesh.

Kolegji për Shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, konstatoi se e ankesa e ankuesit është, e pabazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimin ZP-83/2012 të datës 31.01.2012, Kolegji gjen se ankuesi është i sistemuar në pozitën Zyrtar për Çështje Ekonomike në Drejtorinë Koordinues në Gjilan, pranë Agjencisë së Pyjeve të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës si dhe duke u bazuar në bazën e të dhënave të vendimmarrjes në Këshill, ka konstatuar se ankuesi paraprakisht ka parashtruar ankesë me datë 09.10.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se duhet t'i pranohet kontributi i meritës dhe autorësisë së zyrës shtesë në DKR pranë Agjencisë Pyjore të Kosovës në Gjilan, me ç' rast Këshilli për ankesën e lartcekur sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr. 3068/19 të datës 12.03.2021, ka nxjerr vendimin A.nr.188/2021 të datës 14.04.2021 më numër prot:1784/2021 duke e detyruar Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës të vendos lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 24.07.2019.

Agjencia Pyjore e Kosovës me datë 29.04.2021 e ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se e kanë pranuar vendimin Këshillit me numër A.nr.188/2021 të datës 14.04.2021 dhe të njëjtin e kanë zbatuar, ndërsa kërkesa e ankuesit e datës 24.07.2019 është refuzuar si e pa bazuar. Kundër këtij vendimi ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se të njëjtit i takon e drejta e meritës dhe autorësisë në Zyrën shtesë të Drejtorisë në Gjilan sepse ankuesi ka qenë ideator i projektit.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-065 për Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, përkatësisht nenin 1 me të cilin është përcaktuar së "Ky ligj rregullon: 1.1. të drejtat e autorit që, në bazë të pronës intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit, në vijim e drejta e autorit; 1.2. të drejtat që, në bazë të pronës intelektuale, janë të përafërta me të drejtat e autorit, në vijim të drejtat e përafërta, u takojnë: 1.1.1. interpretuesve përkitazi me interpretimet e tyre; 1.1.2. prodhuesve të fonogrameve përkitazi me fonogramet e tyre; 1.1.3. producentëve të filmit përkitazi me videogramet e tyre; 1.1.4. shërbyesit medial Audiovizuel përkitazi me transmetimet e tyre; 1.1.5. prodhuesve të bazave të të dhënave përkitazi me bazat e tyre të të dhënave; 1.1.6. botuesve përkitazi me botimet e tyre; 1.3. administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta; 1.4. mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta; 1.5. zbatimin e këtij ligji ndaj personave të huaj" si dhe neni 129 të po këtij ligji ku përcaktohet se "Vepra e autorit nga marrëdhënia e punës 1. Kur vepra e autorit krijohet nga i punësuar gjatë marrëdhënies së punës, duke përmblusur detyrat e veta të punës ose sipas udhëzimeve të punëdhënësit, konsiderohet se të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit i janë kaluar ekskluzivisht dhe pakufizime punëdhënësit, për një periudhë dhjetëvjeçare që nga përfundimi i veprës, nëse me kontratën e punësimit apo me një akt tjetër të shkruar me punëdhënësin nuk është parashikuar ndryshe....4. Nëse nuk është kontraktuar ndryshe në mes autorit dhe punëdhënësit, i punësuar si autor i veprës gëzon të drejtën të kërkojë nga punëdhënësi kompensim shtesë, nëse paga e tij është në shpërpjesëtim të dukshëm me fitimet apo kursimet e realizuara në saje të shfrytëzimit të veprës, dhe si rrjedhojë Kolegji duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës, ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë me veprën e autorit në vendin e punës ashtu siç pretendohet nga ankuesi.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, i është referuar edhe dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil i zbatueshëm në kohën kur ankuesi pretendon mbi të drejtën e autorit në zyrën shtesë në Drejtorinë Rajonale në Gjilan, respektivisht nenin 52 i cili parash se: *Nëpunësit civilë i ushtrojnë detyrat e tyre në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe në përshkrimin e detyrave të punës në mënyrë të saktë, të ndërgjegjshme, të rregullt, në kohë dhe pa interes vetjak, në përputhje me interesin publik dhe në përputhje me sistemin juridik të Republikës së Kosovës, si dhe neni 60 i të njëjtit ligj përcakton se: "Nëpunësit civilë duhet ta menaxhojnë me kujdes pronën publike, e cila u është caktuar për ushtrimin e funksioneve të tyre, dhe nuk bën ta*



shfrytëzojnë atë për arsye ose përfitime personale”, e mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me A.nr.413/2021

Flakron Gashi


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjor të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

